



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Kryesia e Kuvendit
P-124
Prishtinë, më 26 tetor 2010, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 26 TETOR 2010

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Naim Maloku, Nexhat Daci, Ibrahim Gashi, Eqrem Kryeziu, Slllobodan Petroviq dhe Numan Baliq, anëtarë të Kryesisë;

Nga grupet parlamentare: Ramë Buja, Ismet Beqiri, Ibrahim Makolli, Lulzim Zeneli, Xhezair Murati dhe Branislav Grbiq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Ismet Hajrullahu, Mehmet Hajrizi.

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Sali Rexhepi, Xheladin Hoxha, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga ZCN: Blerta Bejtullahu dhe
Nga NDI, Shefki Kastrati.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës, si dhe me materialet e shpërndara për këtë mbledhje.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe pesë pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 tetor 2010,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 tetor 2010

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 19 tetor 2010, u miratua pa vërejtje.

2. Konfirmimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare më 28 tetor 2010

Kryesia shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç dhe me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet më 28 tetor 2010, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i Rekomandimit të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për shkarkimin e Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03-L-132 për Protokollin e Shtetit të Republikës së Kosovës,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rezervat shtetërore të mallrave,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/33 për blegtorinë,

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuara shtetërore për siguri,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për metrologji,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L- 139 për shpronësimin e pronës së paluajtshme,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për tregtinë e mallrave strategjike,
14. Shqyrtimi i Propozim- vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për zbatimin e Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar,
15. Shqyrtimi i Propozim- vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale,
16. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë lidhur me Propozim-strategjinë minerare të Republikës së Kosovës për periudhën 2010-2025,
17. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me Projektligjin për qytetin e Prishtinës, dhe
18. Formimi i Organit të Pavarur Përzgjedhës lidhur me emërimin e një anëtari të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Kryesia vendosi që Rekomandimin e Komisionit për Punë të Brendshme lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për zbatimin e Strategjisë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, Rekomandimin e Komisionit për Punë të Brendshme lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për mbrojtjen e të dhënave personale, Rekomandimin e Bordit të Bankës Qendrore për shkarkimin e guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Rekomandimin e Komisionit për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media lidhur me Projektligjin për Qytetin e Prishtinës, nr. 03/L-228 dhe të gjitha projektligjet në lexim të dytë të radhiten për mbledhjen plenare më 28 tetor 2010.

Kryesia, po ashtu vendosi që të hiqen nga rendi i ditës të gjitha projektligjet në lexim të parë, për mbledhjen plenare që do të mbahet më 28 tetor 2010.

3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave

3.1 Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-8 për verërat

Kryesia, në pajtim me nenin 54.4 të Rregullores së Kuvendit, caktoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional, për ta shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, nr. 02/L-8 për verërat dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin preliminar, para shqyrtimit të tij, në parim.

3.2 Raporti i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 2002.7 për telekomunikacionin

Kryesia, pasi e shqyrtoi Raportin e lartcekur, vendosi që kjo pikë të radhitet në një të radhës prej mbledhjeve plenare të radhës.

3.3 Rekomandimi i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për debat parlamentar lidhur me situatën e pensionistëve dhe invalidëve të punës të Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi e shqyrtoi Raportin e lartcekur, vendosi që kjo pikë të radhitet në një të radhës prej mbledhjeve plenare të radhës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit,
Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale